



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.06.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektvendim për miratimin e strukturës së ILDKPKI-së.
2. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Arben Ristani, Eduart Halimi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Xhemal Qefalia, Adelina Rista.

Mungojnë: Mhill Fufi, Tom Doshi

Të ftuar:

Shkëlqim Ganaj - inspektor i Përgjithshëm në ILKDPKI-së.

Flori Karaj - Sekretar i Përgjithshëm në ILKDPKI-së.

Artan Lame - drejtor i Përgjithshëm i ALUIZN-it.

Jeta Velaj - drejtoreshë e Legalizimit.

Fernanda Cenko - specialiste e Marrëdhënieve me Median.

Iglon Peçi – specialist në Ministrinë e Zhvillimit Urban.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Sot në rendin e ditës kemi projektvendimin “Për miratimin e strukturës së ILKDPKI-së.” I ftuar sot në komision është sekretari i Përgjithshëm, zoti Karaji.

Urdhëroni!

Flori Karaj – Faleminderit!

Në ligjin e buxhetit të vitit 2015 është miratuar numri i përgjithshëm i punonjësve, gjithsej 60 vetë, me një shtesë prej 3 punonjësish. Në referencë të nenit 11 të ligjit “Për Inspektoratin e Lartë të deklarimit të Kontrollit të Pasurive”, kërkohet miratimi i detajimit të strukturës organike ku shtesa prej 3 punonjësish të miratohen në pozicionin inspektor. Kjo për shkak të objektivave dhe sfidave që ka ky institucion për kontroll dhe hetim të 1600 zyrtarëve dhe për të ushtruar kontrollin e konfliktit të interesave për 5 mijë zyrtarë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Sekretare e Përgjithshme e Kuvendit i është drejtuar për dhënie mendimi departamentit, i cili është shprehur plotësisht dakord, Ministrisë së Financave, e cila është shprehur, gjithashtu, dakord, për shkak se nuk ka ndryshime financiare.

Zoti Fino, urdhëroni!

Bashkim Fino – Faleminderit!

Në fakt drafti që ka ardhur sot është pak i vonuar, do të thosha, sepse ne kemi kaluar buxhetin e shtetit në muajin nëntor të vitit të kaluar, ku kemi shtuar tre inspektorë të ILKDPKI-së. Kjo nuk bën gjë tjetër në këtë material, veçse ata 3 veta që janë shtuar nga buxheti shteti dhe është miratuar në parlamentin shqiptar, inspektorati na thotë që këta të tre do të futen të punojnë si inspektorë. Mua më vjen mirë që shtohet pjesa kryesore e inspektorëve, që bëjnë punën konkrete dhe jo pjesa ndihmëse mbështetëse, e cila shkon në 60 veta. Po të shikosh pjesën mbështetëse, zoti kryetar janë edhe 16 veta, që janë në funksion të inspektorëve apo të ndihmës

së inspektorëve. Duhet të kemi parasysh se nëse kemi 15 inspektorë dhe 12 ndihmës, ne duhet të shikojmë mundësinë e buxhetit të vitit që vjen që këto të rriten paralelisht, sepse ata punojnë si dyshe, me sa di unë, në punën që bëjnë. Kjo do të thotë se më vonë duhet të shtohen ndoshta edhe 3 ndihmës për të qenë pjesa kryesore e kontrollit.

Ajo që dua të shpreh, zoti kryetar, unë e kam kërkuar gjithmonë (më është vënë në dispozicion edhe një studim, i cili është konstatim me sa e kam parë dhe lexuar), është: pse duhet të merret Kuvendi? I gjithë Kuvendi, 140 burra dhe gra të miratojnë një strukturë? Në qoftë se ne e miratojmë numrin e punonjësve në fund të vitit në buxhetin e vitit për të gjitha institucionet, që janë në varësi të Kuvendit, për Kryeministrinë për ministritë, për Presidencën, nuk miratojmë gjë strukturat e tyre, qoftë edhe të atyre që janë në varësinë tonë, sepse i bie të them që nuk është ndryshe prokurori i Përgjithshëm nga kryeinspektori i Deklarimit të Pasurisë. Pra, që prokurorit të Përgjithshëm t'i miratohet numri nga Kuvendi, nga buxheti dhe e bën vetë strukturën sipas dëshirës. Kjo është një gjë shumë e mirë. E kam për procedurën që duhet rregulluar, sepse jemi ne në Komisionin e Ligjeve, dhe ne na takon ta rregullojmë një gjë të tillë, ne na takon të bëjmë një propozim të tillë.

Cili është propozimi që kam unë? Propozimi im është që Kuvendi duhet të merret me numrin e përgjithshëm të punonjësve dhe e miraton atë në buxhetin e vitit që vjen. Strukturën mund ta miratojë, zoti kryetar, komisioni përgjegjës, mund ta miratojë Kryetari i Kuvendit për institucionet, që janë në varësi të Kuvendit. Nuk ka nevojë të angazhojmë të gjithë Kuvendin, 140 burra dhe gra të ngrenë dorën se cili do të jetë shoferi, cili do të jetë inspektori dhe ndihmës inspektori. Këtë gjë mund ta bëjë komisioni përgjegjës, në rastin konkret për inspektoratin në fjalë e bën Komisioni i Ligjeve, për AMF-në mund ta bëjë komisioni i Ekonomisë. Dhe e mbylлим këtu. Merr certifikimin nga Kryetari i Kuvendit ose shikohet nga komisioni dhe miratohen nga Kryetari i Kuvendit, se janë në varësinë tonë.

Mbi të gjitha, që e kam edhe merak, disa institucione, që varen nga ne, siç është prokurori i Përgjithshëm, e miratojnë vetë dhe disa institucione, që varen po nga ne, nuk e miratojnë dot vetë strukturën, por duhet t'ua miratojmë ne. Pse me dy standarde? Se ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, më thotë kjo këshilltarja këtu, për prokurorin e Përgjithshëm dhe ai mund ta bëjë si të dojë strukturën e vetë, në rastin konkret. Mua kjo gjë nuk më duket korrekte.

Unë jam që ky projekt të kalojë, sepse është thjesht një shtim numri për tre inspektorë që ne kemi miratuar në fund të dhjetorit të viti të kaluar, por jam në vazhdim të atij studimi, që është paraqitur këtu dhe që për mua nuk është shumë i plotë. Ne duhet të vendosim një standard të njëjtë për të gjitha institucionet që varen nga Kuvendi i Shqipërisë. Nuk mund të kemi dy standarde, ku disa e miratojnë vetë strukturën dhe disa ua miratojmë ne si Kuvend.

Pra, kam dy propozime: propozimi i parë është të miratojmë të gjitha strukturat nga komisionet përkatëse dhe të marrin kundërfirmën e Kryetarit të Kuvendit, ose të miratohen nga Kryetari i Kuvendit

E dyta, të mos kemi, siç kemi sot, që disa miratohen në Kuvendin e Shqipërisë, dhe disa të tjera miratohen vetë si në rastin e prokurorit të Përgjithshëm.

Ju e kuptoni që edhe Kryeministri miraton numrin e punonjësve dhe miraton strukturën e çdo ministrie. Ne nuk merremi me të, sepse ne e nxjerrim Kryeministrin, ne e nxjerrim qeverinë, ne e votojmë votëbesimin e qeverisë, por nuk merremi me strukturat e tyre. Strukturat e tyre i bëjnë vetë. Atëherë derisa ata i bëjnë vetë, edhe ne duhet të kemi të njëjtat standarde edhe me institucionet e pavarura që kemi në varësi të Kuvendit dhe kjo të rregullohet për këtë vit përfundimisht, që kur të vijë buxheti i shtetit të kemi mundësi vetëm të miratojmë numrin e punonjësve për çdo institucion të pavarur që është në funksion të Kuvendit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Ka ndonjë gjë nga kolegët? Biem dakord edhe me sugjerimet e bëra?

Kush është dakord me projektvendimin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.06.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Arben Ristani, Eduart Halimi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Xhemal Qefalia, Adelina Rista.

Mungojnë: Mhill Fufi, Tom Doshi.

Të ftuar:

Artan Lame - drejtor i Përgjithshëm i ALUIZN-it.

Jeta Velaj - drejtoreshë e Legalizimit.

Fernanda Cenko - specialiste e Marrëdhënieve me Median.

Fatmir Xhafaj - Fillojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizmin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”.

Kjo është iniciativë e Këshillit të Ministrave, i cili do të shqyrtohet në seancën e ditës së enjte, që do të thotë se duhet ta mbyllim sot këtë projekt.

Kemi votuar në parim. Sot kemi votimin nen për nen.

Mund të fillojmë me nenin 1.

Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Para se të fillojmë votimin nen për nen, do të doja të informoja anëtarët e Komisionit të Ligjeve, që Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka shprehur një mendim për projektligjin e sjellë nga qeveria. Në përgjithësi ky komisionin është dakord dhe bën vetëm një propozim, lidhur me përputhshmërinë e afatit kohor të parashikuar në projektligj që ky afat të përcaktohet në përputhje me ligjin për amnistinë.

Lidhur me pikën 1 të projektligjit, i cili synon të ndryshojë nenin 2. Ka një riformulim si më poshtë vijon: “Në pikën 1 të nenit 2, data 15.01.2009, zëvendësohet me datën 27.06.2014”

Pika 2 shfuqizohet. Shfuqizimi i pikës 2 sjell një riformulim në pikën 4, ku thuhet shprehja “në pikat 1, 2 dhe 3 zëvendësohet me shprehjen “në pikat 1 dhe 2. Pra është thjesht teknike-legjislative.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Zoti Lamaj, urdhëroni!

Artan Lamaj – Dakord. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ka vërejtje apo sugjerime nga deputetët?

Dakord.

Miratohet.

Kalojmë te neni 2 i projektligjit, që është ndryshime në nenin 3 të projektligjit.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 2, sikurse e theksova, zoti kryetar, është thjesht teknik legjislative. Meqenëse kemi shfuqizuar pikën 2 te neni 2, këtu duhet të reflektohet dhe unë e lexova pak më parë që në pikën 4 shprehjet “në pikat 1, 2 dhe 3” zëvendësohen me shprehjen “në pikat 1 dhe 2”. Pra, është thjesht reflektim i ndryshimeve...

Fatmir Xhafaj – Kemi kaluar te neni 2 përkufizime ...

Vasilika Hysi – Po, nuk ka ndryshime këtu.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Ka vërejtje ose sugjerime?

(Diskutime pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Zoti Lame, besoj se e ngritëm si tematikë pas mbledhjes së herës së kaluar. Terminologjia “objektet pa leje”, në mos gabojmë me ligjin aktual ke përkufizimet terminologjike që përdoren “ndërtim pa leje”. Domethënë, çfarë është “objekt pa leje” dhe çfarë është “ndërtim pa leje”?

Nëse ne do të kemi diskordancë midis terminologjisë, nesër do të kemi... Pra definicioni në ligjin ekzistues flet për ndërtim dhe se çfarë është ndërtim. Ndërkohë, objekt mund të jetë çfarëdolloj gjëje.

Artan Lame – Përkufizimi i ligji bazë është: “Ndërtim pa leje është objekti etj., etj...” Dakord. Nuk kam ndonjë kundërshtim. Për unifikim terminologjike mund të përdoret edhe termi “ndërtim pa leje” në të gjithë tipologjinë, sepse, në fund të fundit, pavarësisht nga llojshmëria e rasteve mund të përmbliidhen të fjalat ndërtim.

Fatmir Xhafaj – Si është në...

Artan Lame – Unë ju lexova ligjin bazë, ku thuhet: “Ndërtim pa leje është objekti etj., etj...” Kemi përdorur atë termin “objekt pa leje”, sepse në projektin që ju kemi sjellë, te neni 2, pika 1 thuhet: “Ky ligj zbatohet për objektet pa leje të ndërtuara”. Për të mos pasur përsëritje se do të thoshim për ndërtim pa leje të ndërtuara... Megjithatë nuk kam ndonjë kundërshtim. Kuptimi është i njëjtë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Oerd Bylykbashi – Zoti Lame, jo më kot ligji e ka bërë përkufizimin ndërtim, madje nuk thotë thjesht termin “ndërtim”, por jep edhe karakteristikat për themi teknike se çfarë konsiderohet ndërtim. Pra, është diçka që është ngritur, ka një karabinë është e mbuluar etj., etj., në mos gabojmë janë një seri parametrash që përcaktohen, që do të thotë që kur merret në proces legalizimi merret me këtë. Shteti duhet të merret me këtë lloj tipologjie jo me çfarëdolloj, por themi konstruksioni, i cili nuk përbën ndërtim. Kështu që nesër mund t’u hapet rruga abuzimeve për të bërë legalizime të çfarëdolloj gjëje që mund të jetë bërë dhe jo atyre që konsideron ndërtim me karakter banimi apo me karakter ekonomik. Dikush bën një strukturë të caktuar, e

mbulon tokën dhe pastaj... Kam përshtypjen se nuk është në tipologjinë që paracaktohet aty. Prandaj më mirë vendosni terminologjinë, unifikojeni pastaj çështjet gjyqësore ua lini problemeve që ka redaktimi.

Artan Lame - Për ta mbyllur, jam dakord me zotin Bylykbashi. Pra, për ta bërë jo “ky ligj ndërtohet për objektet pa leje të ndërtuara”, por “ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara”. Tingëllon pak keq. Domethënë ndërtim pa leje i ndërtuar, por për të zhdukur dyshimet tuaja e lëmë edhe kështu.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, propozimi që bëri kolegu Bylykbashi mund të ketë logjikë, por në këtë moment i bie që ta rishikojmë të gjithë ligjin, sepse po t’i referohemi nenit 2, që flet për fushën e zbatimit përdoren termat “objekte të ndërtuara pa leje”, “ndërtime pa leje”. Në pikën ose në paragrafin e dytë të këtij neni përsëri përmendet fjala “ndërtime pa leje”. Fjala “ndërtime pa leje” përmendet edhe në nenet në vijim, të cilat janë sjellë nga qeveria për t’u ndryshuar, por në nenet e tjera që qeveria nuk i ka sjellë.

Ndërhyrja në këtë moment, unë kam një merak, se mund të na zbalancojë terminologjinë me nenet e tjera. Prandaj doja edhe një përgjigje të saktë nga zoti Lame. Do t’i qëndrojmë këtij propozimi që bën zoti Bylykbashi, apo ?

Artan Lame - Është në mënyrë absolute e njëjta gjë. Nuk lë shteg për asnjë lloj ... Meqenëse ligji është ndërruar me dhjetëra herë në gjithë këto vite, ku herë është përdorur “ndërtim”, herë është përdorur “objekt”. Ne përdorëm te ky nen fjalën “objekt” për të mos ...

(Mungesë incizimi.)

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, këtu ka disa ndryshime të vogla më tepër për qartësi, për ata që përfitojnë nga ligji, por edhe për ata që e zbatojnë. Nëse më lejoni, pika 1 e nenit 17 ndryshohet si më poshtë vijon: “Kalimi i të drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objektit pa leje kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil”. Parcela ndërtimore për të cilën kalohet e drejta e pronësisë përcaktohet:

a. Në rastin e ndërtimeve me funksion banimi, si rregull sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i të drejtës së pronësisë duhet të jetë deri në masën e trefshit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 metra katrorë.

b. Për ndërtimet pa leje me funksion social ekonomik zbatohet vetëm kriteri i trefishit të sipërfaqes së bazës së ndërtimit.

c. Për shkak të përmasave të planvendosjes së parcelës ndërtimore. Këtu është shtruar fjala planvendosjes krijohen sipërfaqe të lira që mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim. Ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Kalimi i të drejtës së pronësisë për këto sipërfaqe kryen vetëm nëse poseduesi i ndërtimi pa leje shpreh vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim.

ç. Lista e poseduesve të objekteve pa leje, atëherë do ta bëjmë të ndërtimeve, siç tha zoti Xhafaj dhe sipërfaqet e parcelave ndërtimore për të cilat kryhet kalimi i pronësisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

d. Procedurat dhe rregullat hollësishme që ndiqen nga ALUIZN-i për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ky është riformulimi i kësaj dispozite.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po, është pak a shumë e njëjta ajo e sjellë me disa ndërhyrje të vogla.

Artan Lame – Thelbi është neni 1. Këto janë thjesht ngacmimet tona, që kanë dalë gjatë punës dhe janë saktësime dhe sqarime.

Fatmir Xhafaj – Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar,

Përtej asaj që me këtë ndërhyrje praktikisht duket se, në qoftë se dikush ka zënë dhe mbeten, teprojnë edhe pjesë të tjera, që janë të pashfrytëzueshme edhe kur dikush mund ta ketë pasur truallin ose ta ketë me titull pronësie, e ka zënë dikush dhe ne i themi ia japim atij tjetri që e ka zënë edhe ato pjesë, që ti nuk i shfrytëzon dot më. Do t'i marrë ai dhe do t'i paguajë gjithsesi me çmim të përcaktuar nga shteti.

Pra, praktikisht një pronë private, të cilën personi do ta pranojë me çmimin që do ta përcaktojë shteti, ndërkohë që ky person që i kanë zënë pronën, kushedi se kur do të marrë ndonjë shpërblim nga shteti.

Përveç kësaj ka një kundërsens logjik. Te pika e parë ku ju sugjeroni që ata që i kanë për ndërtime me karakter banimi e kanë deri në 500 metra katrorë, pra trefishin, por jo më

shumë e 500 metra katrorë. Ka një kufizim të ndërtimit pa leje me funksion social- ekonomik, zbatohet vetëm kriteri i trefshit të sipërfaqes së bazës së ndërtimit. Pra, në qoftë se ai bazën e ndërtimit e ka më të madhe, po themi, 500 metra katrorë, shkon 1500, por ai nuk ka asnjë lloj kufizimi.

Praktikisht, nëse baza e ndërtimit, sipas paragrafit të parë do të ishte e tillë që do të prodhonte më shumë se 500, e kufizojmë, kurse, ky tjetri e shkruan si urë të jetë kufizim, vetëm kriteri thuhet këtu, në fakt është pa asnjë lloj kufizimi thjesht i trefshohet sipërfaqja e truallit. Pra, pse të mos ketë kufizim edhe ky? Pse të mos e mbrojë maksimalisht pronën? Vetëm se dikush ndërtoi? Po për çfarë? Jo për hall, jo për të banuar, por ndërtoi në mënyrë të paligjshme. Madje edhe në tokën e shtetit dhe në tokën e dikujt tjetër, të një privati, këtij i njihet e drejta të trefshojë sipërfaqen që ka zënë për ndërtim, e cila shkon maksimumi deri në 500 metra katrorë, kurse po e zure, sepse do të bësh më shumë para...

Fatmir Xhafaj – Jo.

Oerd Bylykbashi – Lexoni këtë që është shkruar këtu.

Fatmir Xhafaj – Zoti Lame, se je i zoti i punës, të lutem, vazhdo!

Artan Lame – Të merremi vesh për diçka, se nuk ka në mënyrë absolute asnjë ndryshim në konceptin e sipërfaqes së truallit nga ligji i vitit 2006 dhe ligji i vitit 2014 me ligjin e sotëm të 2015-s. Pra, të mos themi që po bëjmë ndryshime tani për çështjen e truallit. Kaq ka qenë në vitin 2006, kaq ka qenë në vitin 2014, kaq është edhe në 2015-n, pra kjo që po bëjmë tani.

Kjo e fundit, që thotë zoti Bylykbashi, ka një koncept të tillë, që shtëpi banimi me sipërfaqe mbi 200 metra për kat nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Të lutem, unë flas mbi bazën e statistikave. Ka bejlerë dhe pasanikë sot që kanë edhe shtëpi me sipërfaqe 1 mijë metra, por shtëpia e banimit, tipikja, në një zonë informale, është me sipërfaqe nga 100 deri në 200 metra.

Mund t'i themi: “të japim trefishin e bazës, por nuk mund të kalosh 500 metra”, pra, në qoftë se e ka shtëpinë 200 metra, po marr maksimumin, herë tre, mund të marrë 600 metra. Jo, ne i themi të marrë deri në 500 metra, që të bëjmë kuadratim parcelash në territor. Ky koncept nuk vlen për ndërtime social-ekonomike, sepse ka sipërfaqe nga më të paimagjinueshmet.

Faktikisht, para dy muajsh ne bëmë legalizimet në Fier, ishin stalla bagëtish me sipërfaqe prej 2 mijë metra katrorë.

Ti nuk mund t'i vësh një kufi. Si t'i themi, deri në 10 mijë metra lejohet?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Në ndryshim nga banesat, veprimtaritë ekonomike nuk kanë limite. Mund të ketë 10 mijë metra, mund të ketë 8 mijë metra, mund të ketë 6 mijë metra, mund të ketë edhe 200 metra. Pra, ne vëmë vetëm kufirin e sipërfaqes për ndërtimet social-ekonomike, nuk mund të tejkalohet trefishi i bazës. Në qoftë se ke një serë, apo si rasti i stallave të Fierit, në qoftë se ke stallën që është 1700 metra, herë 3, të takojnë 5 mijë metra. Pra, ti nuk mund të vësh te kjo kategori kufij të sipërm, në një kohë që për banesat, meqenëse flasim për zonë të banuar, ku njerëzit do të jetojnë afër me njëri-tjetrit, është vënë kufiri deri në trefishin e sipërfaqes së bazës, por jo më shumë se 500 metra. Në qoftë se ju mendoni se mund të vini një kufi për ndërtimet social-ekonomike, vëreni, por nuk ka sens.

Fatmir Xhafaj – Po.

Artan Lame – Më fal edhe një herë, zoti Bylykbashi!

Të mos harrojmë që në rastin e njësisve social-ekonomike është me çmim tregu, nuk ka përfitime ndërtuesi, pra e merr të gjithë sipërfaqen me një çmim tregu, ndërsa në rastin e banesës deri në 500 metra e merr me çmim favorizues, pra, e pjesëton për dy dhe gjysmën e asaj që mbetet e merr me letra me vlerë, e kështu me radhë.

Faleminderit.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, nëse dikush ka ndërtuar, po themi, për të bërë biznes me funksion social-ekonomik, nëse ai do të shkonte në tregun e lirë, do të zbatonte ligjin dhe do të shkonte të blinte sipërfaqe domatesh, do të thoshte: “unë do të bëj kaq ndërtim, kaq sipërfaqe trualli më duhet në funksion të asaj dhe do ta paguaj”.

Fatmir Xhafaj – Po, por me çmimin e tregut do ta marrë sërish.

Oerd Bylykbashi – Po, por derisa të kryhet kjo procedurë, ne e dimë si ka ndodhur. Për shembull, në qoftë se dikush do të bëjë një restorant, që shkon me sipërfaqe 600 metra, t'ia shumëzojmë për tre, sepse i duhet edhe oborr për parkim...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dakord, por pse të mos i mbrosh interesat e shtetit dhe të tretëve duke i vënë një kufizim, jo trefishim, por sipërfaqe më të vogël për këtë pjesë? Megjithatë, unë besoj se ka një mekanizëm automatik të gabuar në këtë histori, sepse cenohen të drejtat e të tretëve për prona që ata mund t'i kenë sot, qoftë edhe shteti nga ana tjetër detyrohet të hyjë në një proces, ku tjetri e merr një herë e më pas jep paratë.

Edhe një element. Po flasim për kalimin e të drejtës së pronësisë. Ndoshta mund të bëhet diskutim edhe në pika të tjera të këtij ligji, por është një diskutim i tillë: çdo të ndodhë me këto propozime që po bëni? Ligji i vitit 2006 ka qenë i 2006-s, amendamenti që u bë për shtrirjen e legalizimeve, u bë me qëllim të caktuar, u bë deri në 15 janar të vitit 2009, në mos gabo, kurse ju po e shtrini edhe më tej. Dakord...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ta mbaroj.

Por çfarë ndodh me personat, të cilët kanë marrëdhënie juridike të ndërtuara tashmë midis një pronari dhe një personi, i cili më pas ka bërë ndërtime pa leje dhe nëpërmjet kësaj i lind e drejta të bëjë legalizime? Ne e diskutuam këtë gjë. Pra, si garantoni ju marrëdhënie juridike të stabilizuara më parë, në mënyrë të tillë, që ndërtuesi pa leje, që është një pjesë e marrëdhënies juridike, nuk do të përfitojë dhe do t'ia marrë pronën nëpërmjet një procesi administrativ të legalizimit. Supozoni, dikush ka bërë një kontratë sipërmarrjeje dhe ka filluar ndërtimet në mënyrë të paligjshme. Praktikisht, nëpërmjet këtij ligji, a i lind e drejta këtij ndërtuesi që të legalizojë ndërtimin, përfshirë sipërfaqen, herë tre, dhe më pas t'i thotë tjetrit “unë ta mora pronën, se më doli ky ligji tjetër, nuk na e rregullon më Kodi Civil”?

(Diskutime pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Po, urdhëroni!

Artan Lame – T'i ndajmë gjërat, për pjesën e parë, jemi dakord që nuk ka ndryshime me ligjin e vjetër?

E dyta, zoti Bylykbashi, unë po ju bëj një kundërofertë: më thoni ju çfarë tavani t'u vëmë objekteve social-ekonomike të ndërtuara? T'u themi deri në 10 mijë metra lejohet?

Më jepni një version. Se është kollaj të thuash, por absolutisht nuk mund t'i vësh, sepse janë objekte me sipërfaqe nga më të paimagjinueshmet, që nga 20-30 metra katrorë deri në 2, 3, 4, 5 mijë metra katrorë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Për sa i takon shqetësimit tuaj të fundit, në qoftë se një ndërtues me një pronar trualli kanë bërë një marrëveshje mbi të cilën është marrë një leje ndërtimi, funksionon..

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po çfarë?

Ka bërë marrëveshjen, dhe ndërkohë...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Atëherë, ai ka një marrëveshje, shkon në gjyq dhe bllokun menjëherë procesin. Ka një nen të veçantë ligji “Për legalizimet”, që thotë: “Për trojet, në të cilat ka proces gjyqësor inkorso, në zhvillim, ndërpritet procesi i legalizimit”.

Fatmir Xhafaj – Jemi dakord me ndryshimet e propozuara në nenin 3 nga relatorja? Dakord.

Miratohet.

Neni 4. Ka gjë për të shtuar?

Vasilika Hysi – Neni 4, zoti kryetar, nuk ka ndonjë ndryshim nga projekti që ka sjellë qeveria, vetëm se për teknikë legjislativë ne nuk i referohemi numrit të ligjit dhe datës, por e lëmë “legjislacionit në fuqi”.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Miratohet.

Vasilika Hysi – Gjithashtu, po në këtë nen, në paragrafin e dytë ka edhe një rregullim të emërimit, nga “ZRPP” në “ZQRPP”.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Miratohet neni 4 me ndryshimet e bëra.

Neni 5.

Vasilika Hysi – Te neni 5 kemi një ndryshim të paragrafit të parë, ku pas pikës 2 të nenit 45/1, shtohet pika 3, si më poshtë vijon: “ndërtimet pa leje të përfshira në fushën e zbatimit”.

Fatmir Xhafaj – E qartë. Dakord?

Vasilika Hysi – Po.

Fatmir Xhafaj – Zoti Lame, dakord?

Artan Lame – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, do të doja të sillja në vëmendjen tuaj, që kemi edhe dy shtesa, të cilat i kemi diskutuar në parim. Është konkretisht amendimi i shkronjës “d” të nenit 27, që lidhet me dokumentacionin tekniko-ligjor për legalizimin e objektit. Në bashkëpunim me drejtorinë e ALUIZNI-t kemi bërë riformulimin e shkronjës “d”, e cila ndryshohet si më poshtë vijon: “Vërtetimin ose certifikatën e pronësisë së parcelës ndërtimore ose çdo akt tjetër ligjor për fitimin e pronësisë nëse subjekti e disponon këtë, i njëjti parashikim vlen edhe për objektet me leje, apartamentin ose njësinë e shërbimit në rastin e shtesave pa leje, të realizuara në këto ndërtime”.

E dyta, ne propozuam edhe ndryshimin e nenit 44, që lidhet me animimin, duke e përafruar këtë ligj me kodin e procedurave administrative. Do të doja t’i diskutonim dhe t’i miratonim edhe këto dy shtesa dhe ndryshimet që propozohen.

Fatmir Xhafaj – Atë të kodit të procedurave administrative kur të hyjë në fuqi.

Artan Lame – Jo, është e nevojshme. Ligji i sotëm u lë kompetencë, sepse është ende ligji i vjetër i vitit 2006, që ju lë kompetencë njësive vendore, ankimi e të tjera. Të paktën duhet të bjerë ajo e njësive vendore...

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me ndryshimet e propozuara?

Miratohet.

Neni 6. “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Dakord?

Votojmë në tërësi. Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Një abstenim, vetëm zoti Bylykbashi.

Miratohet në tërësi.

Zoti Lame, mund të thoni diçka në mbyllje?

Artan Lame – Ka një rakordim që do ta vazhdojë vetë komisioni prezent për çështjen e amnistisë dhe të akordimit të datës së amnistisë.

(Diskutime pa mikrofon).

Atëherë, me këtë ligj ne hapëm rrugën se çfarë do të bëjmë me këto 60 mijë ndërtime pa leje, si do të veprohet me produktin e veprës.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Në rregull, thjesht për amnistinë. Unë thjesht jua kujtoj për të rakorduar, ju e dini vetë.

Plus, është edhe fakti i përputhjes së datës, sepse po u bë, ka qenë deri në datën e hyrjes në fuqi të asaj amnistie, që ishte, në mos gaboj, prill i vitit 2014, në një kohë që ky amnistion...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jo, duhet ta diskutoni ju dhe të vendosni njërën nga të dyja. Ose do të ndryshoni, këtë ta çoni këtu, ose ky do të shkojë atje.

Personalisht, më heq kërraba nga vetja, në kuptimin që të vijë amnistia te kjo datë që u rakordua sot.

Fatmir Xhafaj – Dakord, faleminderit!

MBLEDHJA MBYLLET